



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 206, datë 25.3.2021

P Ë R

PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN
E RINDËRTIMIT TË STACIONIT TË ZJARRFIKËSES DHE GODINËS
SË BORDIT TË KULLIMIT, BASHKIA KAVAJË, DHE CAKTIMIN
E BASHKISË KAVAJË SI NJËSI ZBATUESE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në vlerën 227 211 426 (dyqind e njëzet e shtatë milionë e dyqind e njëmbëdhjetë mijë e katërqind e njëzet e gjashtë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të stacionit të zjarrfikëses dhe godinës së bordit të kullimit, Bashkia Kavajë, sipas detajimit të mëposhtëm:
 - a) Rindërtimi i stacionit të zjarrfikëses, Bashkia Kavajë, në vlerën 79 301 115 (shtatëdhjetë e nëntë milionë e treqind e një mijë e njëqind e pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH;
 - b) Rindërtimi i godinës së bordit të kullimit, Bashkia Kavajë, në vlerën 147 910 311 (njëqind e dyzet e shtatë milionë e nëntëqind e dhjetë mijë e treqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.
2. Bashkisë Kavajë, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, i transferohet fondi në masën 45 442 285 (dyzet e pesë milionë e katërqind e dyzet e dy mijë e

dyqind e tetëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, sipas detajimit të mëposhtëm:

- a) Për rindërtimin e stacionit të zjarrfikëses, Bashkia Kavajë, në vlerën 15 860 223 (pesëmbëdhjetë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë e dyqind e njëzet e tre) lekë pa TVSH;
 - b) Për rindërtimin e godinës së bordit të kullimit, Bashkia Kavajë, në vlerën 29 582 062 (njëzet e nëntë milionë e pesëqind e tetëdhjetë e dy mijë e gjashtëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.
3. Caktimin e Bashkisë Kavajë si njësi zbatuese për rindërtimin e stacionit të zjarrfikëses dhe godinës së bordit të kullimit.
4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRACE

**MINISTRI I SHTETIT
PËR RINDËRTIMIN**

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 1567/1
DATË 29.3 2021

MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
BASHKISË KAVAJË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGACI

